

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-154/2015**

Prishtinë,  
20 shtator 2017

Në çështjen juridike të:

**E. B.**

**Pala ankuese**

Kundër

Askush

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013 të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA40406), pas shqyrtimit të mbajtur më 20 shtator 2017 mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga E. B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2013 të datës 27 nëntor 2013 lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA30066, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/223/2013 i datës 27 nëntor 2013 sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA30066, vërtetohet.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 7 maj 2007, E. B. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP) duke kërkuar ri posedimin e shtëpisë me sipërfaqe prej 48m<sup>2</sup>, e cila gjendet ne vendin e quajtur “Vitomirica”, Komuna e Pejës (tani e tutje: prona e kërkuar). Numri i ngastrës kadastrale në të cilën gjendet prona e kërkuar nuk është specifikuar nga pala ankuese. Pala ankuese deklaroi se babai i tij i ndjerë R. B. është pronar i pronës së kërkuar dhe se të drejtën mbi pronën e kërkuar e kishte humbur më 12 qershor 1999 për shkak të konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit dhe 20 qershorit 1999.
2. Përveç certifikatës së vdekjes nr. 200-3/98 të lëshuar më 5 shkurt 1998 nga zyra e regjistrimit civil në Vitomiricë, në të cilën figuron se babai i palës ankuese R. B. ka vdekur më 1 shkurt 1998 dhe letër konfirmimin nr. 9/98 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Pejës më 5 shkurt 1998 lidhur me shpenzimet e varrimit, pala ankuese nuk ka dorëzuar asnjë dokument tjetër lidhur me pronën e kërkuar.
3. Njoftimi i pronës është bërë më 25 janar 2008. Prona e kërkuar është shtëpi e cila nuk ishte e zënë. Pasi që pala ankuese nuk e ka specifikuar numrin e ngastrës apo ndonjë informatë tjetër lidhur me tokën në të cilën gjendet shtëpia, nuk ka asnjë dyshim lidhur me besueshmërinë e raportit të njoftimit.  
Kërkesa konsiderohet jokontestuese nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së sepse asnjë palë nuk ka paraqitur përgjigje brenda afatit prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079.
4. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka gjetur sipas detyrës zyrtare dy fleta poseduese (fletën poseduese nr. 242 dhe fletën poseduese nr. 631) në emër të babait të palës ankuese. Të

dy fletat poseduese janë lëshuar më 16 shkurt 2010 nga Komuna e Pejës, Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.

5. Pala ankuese është kontaktuar nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së për të siguruar informata të hollësishme lidhur me pronën e kërkuar, si numrin e ngastrës kadastrale në të cilën gjendet shtëpia. Pala ankuese nuk ka treguar interesim për të bashkëpunuar me zyrtarin e Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së.
6. Me 27 nëntor 2013, KKKPK-ja me vendimin KPCC/D/R/223/2013 e ka refuzuar kërkesën e palës ankuese me arsyetimin se ai nuk e ka dëshmuar pronësinë ose ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para ose gjatë konfliktit të vitit 1998-1999.
7. Më 24 dhjetor 2014, palës ankuese i është dorëzuar vendimi, kurse më 21 janar 2015 ai ka paraqitur ankesë.

### **Pretendimet e palës ankuese**

8. Pala ankuese ka kundërshtuar vendimin e KKKPK-së duke theksuar se vendimi përmban gabime fundamentale dhe shkelje të rënda të ligjit të procedurës dhe atij material si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.
9. Sipas palës ankuese sipërfaqja prej 48 m<sup>2</sup> (sipërfaqja e shtëpisë) është pjesë e ngastrës kadastrale nr. 1031/1 dhe i takon atij dhe vëllait të tij në bazë të vendimit mbi trashëgiminë.
10. Pala ankuese i ka bashkangjitur ankesës
  - Vendimi mbi trashëgiminë nr. 187/12 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Pejës në të cilin figuron se pala ankuese dhe vëllai i tij E.B. kanë trashëguar pronën nga babai i tyre i ndjerë.

### **Arsyetimi ligjor**

### **Pranueshmëria e ankesës**

11. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç është përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

**Meritat e ankesës**

12. Gjykata Supreme ka shqyrtuar vendimin e kundërshtuar sipas dispozitave të nenit 194 të Ligjit mbi procedurën kontestimore nr. 03/L-006 (tani e tutje: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese ka gjetur se ankesa është e pabazuar.
13. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja kë lëshuar vendim të drejtë kur ka refuzuar kërkesën.
14. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës “dëshmon” të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe gjithashtu dëshmon se ai nuk është në gjendje ta ushtojë të drejtën e tillë pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
15. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese është dashur të paraqes prova në mbështetje të kërkesës për ta vërtetuar të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme.
16. Përveç sipërfaqes së pronës së kërkuar pala ankuese nuk ka dhënë asnjë informatë tjetër, për shembull, numrin e ngastrës kadastrale në të cilën gjendet prona e kërkuar, e po ashtu nuk ka dorëzuar asnjë provë në mbështetje të kërkesës edhe pse ishte këshilluar nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP që ta bëjë një gjë të tillë.
17. Vetëm në fazën e apelit, pala ankuese ka deklaruar numrin e ngastrës kadastrale në të cilën gjendet prona e kërkuar që është 1031/1 dhe vendimin mbi trashëgiminë në të cilin figuron se ai është bërë bashkëpronar i ngastrës kadastrale nr. 1031/1 në emër të palës së tretë.
18. Sidoqoftë, provat e reja të dorëzuara nuk janë marrë parasysh nga gjykata. Në bazë të nenit 12.11 të Ligjit nr. 03/L-079:  
*Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë.*
19. Pala ankuese është kontaktuar nga Sekretariati Ekzekutiv i KAP-së dhe është këshilluar që të ofroj më shumë informata lidhur me pronën të cilën e kërkon si dhe të paraqes prova në mbështetje të kërkesës së tij, mirëpo ka dështuar që ta bëjë këtë. Ky fakt e sjell

gjykatën në përfundim se pala ankuese tashmë ka mundur t'i përdorë këto prova gjatë procedurës në KKPK pasi që nuk ka pasur asnjë pengesë që ta bëjë këtë.

20. Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar gjatë një procedure të rregullt. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të të drejtave materiale ose vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.
21. Në bazë të asaj që u tha më lart, në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafin (c) të Ligjit 03 / L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Shukri Sylejmani, Gjyqtar**

**Bjorn Olof Brautigam, Referente i EULEX-it**